

A N K E S Ë

ANKUES: Erion Veliaj, i biri i Luanit dhe i Shqiponjës, i datëlindjes 17.12.1979, lindur e banues në Tiranë.

DREJTUAR: INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
TIRANË

PËR DIJENI: KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
TIRANË

OBJEKTI: Kërkesë për pezullim nga detyra të prokurorit të Prokurorisë të Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, zotit Ols Dado.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
Ligji Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.
Ligji Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor”.
Ligj Nr.84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligj Nr.96/2016, datë 30.8.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 153.

I nderuar Inspektor i Lartë i Drejtësisë,

Si fillim dëshirojmë t’ju urojmë suksese në misionin tuaj, dhe në vijim, vlerësojmë t’ju njohim me faktet, rrethanat duke vërtetuar konfliktin e hapur të interesit që zoti Ols Dado, prokuror i çështjes penale, ka me shtetasin në hetim, personin tim, Erion Veliaj, konflikt i cili ka ndikuar në prishjen e imazhit, kufizimin e lirisë duke servirur përpara Gjykatës së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar një material në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e hetimit korrekt e të mbështetur në ligj e në prova.

A. RRETHANA DHE FAKTE:

Ashtu sic Ju dhe mbarë opinioni publik e dini, ndaj meje, në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ditën e hënë, datë 10.02.2025, në mesditë u ekzekutua masa e sigurimit personal, arrest me burg të lëshuar nga prokuror, zoti Ols Dado, dhe të ligjëruar nga gjyqtari i cështjes zoti Erion Bani.

Qysh nga momenti i ndalimit e në vazhdim jam duke vijuar betejën time ligjore kundër paligjshmërisë, së pari të masës të sigurimit personal, dhe së dyti për të vërtetuar hap pas hapi pavërtetësinë e akuzave të ngritura ndaj meje si i dyshuar për veprat penale:

1. Korrupsioni pasiv i zyrtarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë kryer ne bashkëpunim (9 herë)
2. Pastrimi i i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale parashikuar nga neni 260, 25 dhe 287\2 i Kodit Penal.

B. SHKAKU I KËRKESËS

Thelbi i kërkesës të depozituar nga ana ime konsiston te qëndrimi që unë kam bërë publik për largimin nga cështja të prokurorit ndërtues zotit Ols Dado i cili nuk mundet kurrësesi të jetë objektiv në përfaqësimin e akuzës të ngritur ndaj personit tim.

E them këtë pasi Ols Dado ka përdorur telefonin e paguar nga taksat e taksapaguesve për të kërkuar leje ndërtimi për përfitimet e tij, dhe pasi kërkesa e tij për miratim të kateve shtesë iu refuzua “u vërsul” me shprehje kërcënuese e shantazhuese.

Prokurori i cështjes i cili ka ngritur akuzat ndaj meje nuk duhej të pranonte hetimin e shkaqeve të ngritura në kallzimin penal të depozituar nga i ashtuquajti “Nesti Angoni”, pasi Olsi Dado ka përfituar sipërfaqe ndërtimore miratuar, me vendimin nr. U-14078/4, datë 09.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, dhe lejen e ndërtimit nr. U-14078/6, datë 21.09.2021.

Është e vërtetë që leja e ndërtimit i është akorduar subjektit zhvillues/ndërtues, shoqërisë “Alb Edil” sh.p.k, por referuar kontratës së sipërmarrjes nr. Rep 2040, nr. Kol 803, datë 06.05.2021 pala porositëse dhe përfituese njëkohësisht është prokurori i cështjes kundër titullarit të institucionit që ka dhënë lejen e ndërtimit pra personit në hetim Erion Veliaj.

Sic e parashtrova edhe më lart fakti që përfitues nga procedura e dhënies së lejes së ndërtimit është prokurori Olsi Dado është i pandryshueshëm, pasi e vërteton dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës time.

Telefonatat e prokurorit i cili shpreh pakënaqësinë në lidhje me procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit, dëshmojnë qartë qëllimin keqdashës të zotit Ols Dado për të pasqyruar në dosjen hetimore fakte të pavërteta.

Edhe nëse zoti Ols Dado nuk do të ushtronte ndikimin e tij në lidhje me lejen e ndërtimit, mjafton vetëm fakti se është përfitues, për tu vërtetuar konflikti i interesit.

Thjesht fakti që prokurori është subjekt përfitues nga leja e ndërtimit, do të thotë se ndodhet në konflikt të hapur interesi e për pasojë nuk duhet të kishte përfaqësuar akuzën që në krye të herës.

Në një rast hipotetik, (interpretim i kundërt), si për shëmbull, sikur zoti Ols Dado të ishte favorizuar nga titullari i Bashkisë Tiranë, përsëri do të kishte konflikt interesi pasi edhe

nëse faktet e pretenduara në dosjen hetimore të ishin të vërteta, do të ishte lehtësuar pozita e të dyshuarit në hetim.

Pra në të dyja rastet prokurori Dado është në konflikt të hapur interesi.

Ligji Nr.96/2016, datë 30.8.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 102, pika 1, germa a/b/iii përcakton shprehimisht se: “Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë në vecanti, por pa u kufizuar në to, veprimet apo mosveprimet ose sjelljet e magistratit si më poshtë:

- a) Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i cështjes kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla
- b) Paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i cështjes nëse ky veprim:
 - iii) Nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun.

Sa më sipër, bazuar në nenin 127 të ligjit Nr.96/2016 do të kërkoja nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullimin e prokurorit, zotit Ols Dado nga detyra e tij si prokuror, sipas parashikimeve në nenin 151, të këtij ligji, ose të kërkojë vetë pezullimin e magistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.

Në këto kushte dhe përsa parashtroj më sipër, bazuar në nenin 184 e vijues të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor”,

KËRKOJ:

- Fillimin e procedurave për procedimin disiplinor ndaj prokurorit, zotit Ols Dado, lidhur me shkeljet e kryera në shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të personit tim, Erion Veliaj.
- Marrjen e masës disiplinore ndaj tij dhe pezullimin nga detyra.

ANKUES

Erion Veliaj

